

## STATUTI

### SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“PEDAGOGU” SHPK

#### KREU I

*Pjesa e përgjithshme*

Ky statut, akti i themelimit dhe Ligji Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, rregullojnë marrëdhëniet midis ortakëve të shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar “PADAGOGU” SHPK.

#### KREU II

Emri, Forma, Zyra Qëndrore, Objekti i veprimitarisë, Kohëzgjatja, Degët dhe Zyrat e Përfaqësimit, Përgjegjësia e Ortakëve.

#### NENI 1

*Emri*

Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar mban emrin “PEDAGOGU” SHPK. Ndryshimi i emërtimit të shoqërisë mund të bëhet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

#### NENI 2

*Forma*

Shoqëria tregtare “PEDAGOGU” SHPK, ka formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar.

#### NENI 3

*Zyra Qëndrore*

3.1 Shoqëria tregtare me përgjegjësi te kufizuar “PEDAGOGU” SHPK, do të ketë zyrën e saj qëndrore ne: DURRES Lagjia 2 Rruga : ”Sefer Efendiu”, Pallati “Four Sister”, zone kadastrale 8512, nr.pasurie 22/593/ND-N-20.

3.2 Ndryshimi i zyrës qëndrore të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë.

#### NENI 4

*Objekti i veprimitarisë*

Shoqëria ka si objekt aktiviteti në Shqipëri dhe jashtë:

Kurse te formimit professional, Murature dhe Suvatime.

A handwritten signature in blue ink, appearing to read "Dukagjin".

A handwritten signature in blue ink, appearing to read "Rexhep".

### NENI 5

#### *Kohëzgjatja*

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj për një periudhë deri me date 31/Dhjetor/2050 dhe mund te shtyhet sipas ligjeve ne fuqi.

### NENI 6

#### *Degët dhe Zyrat e Përfaqësimit*

Shoqëria tregtare "PEDAGOGU" SHPK mund të hapë degë të saj ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë vendit.

### NENI 7

#### *Përgjegjësia e Ortakëve*

Ortakët nuk përgjigjen për detyrimin e shoqërisë "PADAGOGU" SHPK dhe mbulojnë personalisht

### **KREU III**

**Kapitali I Regjistruar dhe Kuotat, Zmadhim i Zvogëlimi I Kapitalit, Kalimi I Kuotave të Kapitalit**

### NENI 8

#### *Kapitali I Regjistruar dhe Kuotat*

8.1 Kapitali i regjistruar i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "PADAGOGU" SHPK është 100.000 (njeqind mijë) Leke, ndarë në 2 kuota, e cila është nënshkruar dhe derdhur rregullisht nga të gjithë ortakët.

8.2 Ortakët kanë kontribuar në krijimin e kapitalit të shoqërisë dhe zoterojnë kuotat e tyre në këtë mënyrë:

Z – ROMIR REXHA, është ortaku i shoqërisë, i cili zoteron 1 kuotë, pjesëmarrja në përqindje eshte e barabartë me 50% të kapitalit të shoqërisë, me vlerë kapitali 50.000 (pesedhjete mijë) Leke

Z – DARDAN SEFERAJ, është ortaku i shoqërisë, i cili zoteron 1 kuotë, pjesëmarrja në përqindje eshte e barabartë me 50% të kapitalit të shoqërisë, me vlerë kapitali 50.000 (pesedhjete mijë) Leke

### NENI 9

#### *Zmadhimi I Kapitalit të Regjistruar*

9.1 Kapitali i regjistruar i shoqërisë mund të zmadhohet pa kufi, një ose disa herë , me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

9.2 Në rast zmadhimi të kapitalit të regjistruar të shoqërisë, të gjithë ortakët kanë të drejtë të nënshkruajnë dhe shlyejnë pjesët e kapitalit të zmadhuar në proporcione pjesëmarrjen e tyre në kapital.

### NENI 10

2

### **Zvogëlimi I Kapitalit të Regjistruar**

10.1 Shoqëria mund të zvogëlojë kapitalin e regjistruar me vendim të Asamblesë së Përgjithshme. Në çdo rast, kapitali i regjistruar i shoqërisë nuk mund të zvogëlohet nën minimumin e kërkuar nga ligji.

10.2 Zvogëlimi i kapitalit i prek ortakët në proporcion me pjesëmarrjen e tyre në kapital, me përjashtim të rastit kur në bazë të ligjit ose statutit Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë ndryshe.

#### **NENI 11**

#### ***Kalimi I Kuotave të Kapitalit të Regjistruar***

11.1 Kuotat e kapitalit mund t'u kalohen tërësisht ose pjesërisht të tretëve, ortakë ose që nuk bëjnë pjesë në shoqëri me kushtëzimet e mëposhtme:

Ortakët e shoqërisë kanë të drejtën e parablerjes për kuotën që dëshiron të shesë njëri prej ortakëve të shoqërisë.

Ortaku që dëshiron të shesë kuotën e tij ia ofron atë ortakëve të tjerë nëpërmjet administratorit.

Ortakët e tjere kanë të drejtën e parablerjes së kuotës me të njëjtat kushte dhe me të njëtin çmim që ortaku mund t'ia shesë këtë kuotë një të treti që nuk bën pjesë në shoqëri.

Brenda 10 (dhjetë) ditëve nga dita e paraqitjes së ofertës, ortakët e tjerë duhet te përgjigjen për ushtrimin e të drejtës së parablerjes ose, në të kundërt, do të konsiderohet se ata kanë hequr dorë prej saj. Në rast se ortakët që do të ushtrojnë të drejtën e parablerjes janë më shumë se një, kuota ndahet ndërmjet tyre në pjesë të barabarta.

Në rast se ortakët nuk e ushtrojnë të drejtën e parablerjes për kuotën që dëshiron të shesë njëri prej ortakëve të shoqërisë atëherë kjo e drejtë mund të ushtrohet nga vetë shoqëria. Ortaku që dëshiron të shesë kuotën e tij ia ofron atë shoqërisë.

Shoqëria ka të drejtën e parablerjes së kuotës me të njëjtat kushte dhe me të njëtin çmim që ortaku mund t'ia shesë këtë kuotë një të treti që nuk bën pjesë në shoqëri.

Brenda 10 (dhjetë) ditëve nga dita e paraqitjes së ofertës, shoqëria duhet të ushtrojë të drejtën e parablerjes ose, në të kundërt, do të konsiderohet se ajo ka hequr dorë prej saj. Në rast se shoqëria vendos të ushtrojë të drejtën e parablerjes ajo duhet të autorizojë administratorin për të blerë kuotën dhe të vendosë anullimin e saj. Në këtë rast, shoqëria duhet të zvogëlojë kapitalin e regjistruar me vlerën nominale të kuotës së anuluar. Si pasojë e këtij zvogëlimi të kapitalit do të ndryshojë edhe raporti i pjesëmarrjes në kapital të ortakëve të shoqërisë.

Në rast se ortaku që tjetërszon kuotën e vet, ia shet atë një të treti jashtë shoqërisë, me çmim dhe kushte më të favorshme nga ato që ua ka ofruar ortakëve të shoqërisë për efekt të ushtrimit të së drejtës së parablerjes nga ana e tyre, atëherë kontrata e shitjes që ortaku do të lidhë me personin e tretë do të jetë e pavlefshme dhe shoqëria nuk do të japë miratimin për këtë kalim.

11.2 Të gjitha njoftimet në funksion të zbatimit të këtij nenit do të bëhen me shkrim me letër të porositur (rekomande).

#### **NENI 12**

#### ***Derdhje dhe financime të ortakëve***

12.1 Ortakët, me pëlqimin e Asamblesë së Përgjithshme, mund t'i përgjigjen kërkesave financiare të shoqërisë përmes derdhjeve të ndryshme të kryera në çfaredo lloj forme si kontribute finançiare që do të përdoren në të ardhmen për rritjen e kapitalit, pra në kapital, pa të drejtë rikthimi të shumave të derdhura, për mbulimin e humbjeve të shoqërisë.

12.2 Financimet e mundshme jofitimprurëse mund të kryhen nga ortakët në favor të shoqërisë por vetëm në respektim të plotë të normativave për transparencën bankare në këtë fushë.

#### KREU IV

##### Organet e Shoqërisë

###### NENI 13

###### *Asambleja e Përgjithshme*

Organi vendimmarrës i shoqërisë është Asambleja e Përgjithshme.

###### NENI 14

###### *Të Drejtat dhe Detyrimet e Asamblesë së Përgjithshme*

Asambleja e Përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqerinë në lidhje me çështjet e mëposhtme:

- përcaktimin e politicave tregtare të shoqërisë;
- ndryshimet e statutit;
- emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- emërimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertës kontabël të autorizuar;
- përcaktimin e shpérblimeve për administratoret, likuiduesit dhe ekspertët kontabël të autorizuar;
- mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- miratimin e pasqurave financiare vjetore dhe te raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve,
- riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- shpérndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- anulimin e kuotave;
- largimin ose përjashtimin e ortakut;
- çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo nga ky statut.

###### NENI 15

###### *Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme*

15.1 Asambleja e Përgjithshme mblidhet në rastet e përcaktuara nga ligji dhe nga ky statut, sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë.

15.2 Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme thirret të paktën një herë në vit.

15.3 Asambleja e Përgjithshme thirret në respektim të parashikimeve të neneve 83 dhe 84 të ligjit Nr. 9901, datë 14.01.2008 'Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare'.

15.4 Ortakët do të njoftohen për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme me anë të një letre të porositur (rekomande) ose postës elektronike;

Ortakët janë të detyruar që të depozitojnë me shkrim pranë administratorit të shoqërisë adresën në të cilën do t'i dërgohet njoftimi nga shoqëria me anë të letrës se porositur (rekomande), si dhe adresën e postës elektronike ku do t'i dërgohet njoftimi me anë të postës elektronike. Dërgimi i njoftimit në këto adresa do të konsiderohet si njoftim i kryer rregullisht.

15.5 Njoftimi për mbledhje duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës.

15.6 Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme mund të mbahet në zyrën qëndrore (selinë) të shoqërisë ose në një vend tjetër të propozuar nga administrator dhe të miratuar nga ortakët. Miratimi në këtë rast do të jepet nga ortakët nëpërmjet postës elektronike. Për zhvillimin e mbledhjes në një vend tjetër jashtë selisë së shoqërisë, duhet të jenë pro ortakët të cilët përfaqësojnë 51 % të kapitalit të shoqërisë. Në rast se ortakët nuk bien dakord për zhvillimin e bledhjes ne një vend tjetër, atehere mbledhja do të mbahet në selinë e shoqërisë.

#### NENI 16

##### *Pjesëmarrja në Vendime*

16.1 Çdo ortak ka të drejtë vote në përpjesëtim me kontributin e tij në kapitalin e shoqërisë.

16.2 Çdo ortak mund të përfaqësohet në Asambleën e Përgjithshme nga një ortak osë nga një person i tretë, në bazë të një autorizimi. Ky autorizim mund të jepet vetëm për një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

16.3 Ortaku nuk mund të përfaqësohet në Asambleën e Përgjithshme nga Administratori.

#### NENI 17

##### *Kuorumi*

17.1 Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme në çdo rast janë të vlefshme nëse të marrin pjesë personalisht osë të përfaqësuar, ortakët të cilët zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votimeve në Asamble.

17.2 Për vendime të cilat kërkojnë një shumicë të zakonshme, Asambleja e Përgjithshme merr vendime të vlefshme me 51 % të votimeve pro të ortakëve pjesëmarrës në mbledhje.

17.3 Per vendime të cilat kërkojnë një shumicë të vlerësuar, si ndryshimi i statutit, zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit të regjistruar, shpërndarja e fitimeve, riorganizimi dhe prishja e shoqërisë, anulimi i kuotës së kapitalit, largimi i ortakut, Asambleja e Përgjithshme merr vendime të vlefshme me tre të katërtat (3/4) e votave pro të ortakëve pjesëmarrës në mbledhje.

17.4 Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorimit të përmendur në nenin 17.1 asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend ditor.

#### NENI 18

##### *Procesverball I Mbledhjes*

Të gjitha vendimet e Asamblesë së Përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal.

Procesverballi përban datën, vandin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e Kryetarit të Mbledhjes, emrin e Mbajtësit të Procesverbalit, rezultatet e votimit.

Për mbajtjen e procesverbalit, Kryetari i Mbledhjes cakton një Mbajtës Procesverballi, i cili mund të mos jetë ortak. Procesverballi I mbledhjes nënshkruehet nga Kryetari I Mbledhjes dhe Mbajtësi I Procesverbalit.

Procesverballit I bashkangjitet lista e pjesëmarrësve dhe njoftimi I mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme .

#### NENI 19

##### *Administratori*

19.1 Administratori është organi ekzekutiv i shoqërisë.

19.2 Shoqëria administrohet nga një administrator që emërohet dhe shkarkohet nga Asambleja e Përgjithshme. Afati i emërimit është 5 (pese) vjet me të drejtë ripërtëritje.

19.3 Administratori ka të drejtë të kryejë administrimin e zakonshëm të shoqërisë. Ai ka të drejtë të përfaqësojë shoqërinë pranë çdo organi shtetëror si dhe në marrëdhënie me të tretët, të hartojë dhe të nënshkruejë çdo dokument të nevojshëm lidhur me mbarëvajtjen e aktivitetit të shoqërisë si dhe t'i depozitojë ato pranë çdo organi kompetent shtetëror, apo personave të tretë privatë, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

Të kujdeset për mbarëvajtjen e punëve të përditshme të shoqërisë, duke kryer të gjitha veprimet e nevojshme lidhur me mbikqyrjen e personelit; punësimin dhe pushimin nga puna të personelit; dhënen e udhezimeve lidhur me mënyrën e menaxhimit të punëve në shoqëri; mbajtjen e korrespondences së shoqërisë; dhënen e autorizimit për blerjen, marrjen me qëra etj. të mallrave apo shërbimeve të zakonshme të cilat lidhen në mënyrë direkte apo të tërthortë me punën e përditshme të shoqërisë; autorizimin për kryerjen e transferimeve bankare apo tērheqjen e shumave të nevojshme nga llogaritë e shoqërisë lidhur me pagat apo shpërbllimet e punonjësve të shoqërisë; të përpilojë dhe të nënshkruejë faturat tatimore që do të lëshohen në emër të shoqërisë



si rezultat i punëve të kryera; të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme dhe të nënshkruajë cdo dokument për kryerjen e pagesave bankare, depozitime, tërheqje, derdhje, si dhe transferime apo lëvizje të cdo lloji në llogaritë bankare të shoqërisë, në të gjitha numrat e llogarisë të Shoqërisë, pranë cdo banke ku ndodhen këto llogari; të përfaqësojë shoqërinë në lidhje me negocimin, hartimin dhe lidhjen e cdo lloj kontrate ose marreveshje me persona fizike apo juridikë vendas qse të huaj, me institucionet apo ente të ndryshme shtetërore si dhe cdo subjekt tjetër.

19.4 Për administrimin e zakonshëm të shoqërisë të përcaktuar në nenin 19.3, Asambleja e Përgjithshme me vendim të posaçëm, një herë në vit, përcakton shumën limit me të cilën Administratori mund të kryejë veprimet e sipërcituara.

19.5 Për administrimin e jashtëzakonshëm të shoqërisë, e cila do të kalojë kompetencat e përcaktuara ne nenin 19.3 dhe shumën limit mbi të cilën do të marrë vendim Asambleja e Përgjithshme sipas nenit 19.4, Administratori do të kryejë veprime vetëm mbi bazën e një vendimi të Asamblesë së Përgjithshme .

19.6 Administratori i parë i shoqërisë është Z. ALBAN DAKOLI, i datëlindjes 21/11/1982, lindur në Durres, SHQIPERI, banues në Durres, Lagjja nr. 4, Rruga: Hafiz Podgorica, P.157, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i kartës së identitetit me nr. personal I21121050R

#### KREU V

*Eksperti Kontabël, Viti Financiar dhe Bilanci Vjetor, Shpërndarja e Fitimeve*

#### NENI 20

*Eksperti Kontabël*

Nëse është e nevojshme ose kërkohet nga ligji, kontrolli i bilancit financiar dhe i librave të kontabilitetit të Shoqërisë do t'i besohet një eksperti kontabël të autorizuar, të emëruar nga Shoqëria.

#### NENI 21

*Viti Financiar dhe Bilanci Vjetor*

Viti finanziar fillon me 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor.

Bilanci vjetor, inventari, raporti i ecurisë së veprimitarisë dhe raporti i ekspertit kontabël të autorizuar, miratohet nga Asambleja e Përgjithshme .

Dokumentet që kanë të bëjnë me ushtrimin e vitit financiar do të miratohen brenda 3 (tre) muajve nga përfundimi i vitit financiar.



## NENI 22

### *Shpërndarja e Fitimeve*

Ortakët kanë të drejtë të ndajnë pjesën e fitimit të deklaruar në pasqyrat financiare të shoqërisë. Fitimi u shpërndahet ortakëve në raport me kuotat e zotëruara.

Shoqëria mund t'u shpërndajë fitime ortakëve vetëm nëse pas pagimit të dividentëve:

- aktivet e shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj;
- shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim.

Dividendët do të shpërndahen, duke vënë mënjanë një pjesë prej të paktën 5% (pesë për qind) për rezervën ligjore.

## KREU VI

### Riorganizimi I Shoqërisë, Prishja dhe Likuidimi I Shoqërisë , Largimi dhe Përjashtimi I Ortakëve

## NENI 23

### *Prishja dhe Likuidimi I Shoqërisë*

23.1 Shoqëria prishet në rastet e parashikuara nga ligji ose me vendim të Asamblesë së Përgjithshme. Në rast prishje shoqëria do t'l nënshtrohet procedurës së likuidimit.

23.2 Asamblea e Përgjithshme ne rastet e prishjes cakton një ose më shumë likujdatör, per te cilin cakton dhe shpërblimin.

23.3 Për procedurën e likuidimit të Shoqërisë do të aplikohet legjislatoni shqiptar në fuqi.

## KREU VII

### *Dispozita të Fundit*

## NENI 24

Të gjitha mosmarrëveshjet midis ortakëve duhet të zgjidhen me mirëkuptim. Në rastet kur ato nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim secili prej ortakëve ka të drejtë t'i drejtohet për zgjidhje gjykatës kompetente.


**NENI 25**

Për sa nuk është parashikuar në këtë Statut do të aplikohet Ligji Nr. 9901 , datë 14.04.2008, ‘Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, si dhe legjislativë shqiptar në fuqi.

*Ky statut përpilohet në 4 (katër) origjinale në gjuhën shqipe.*

***ORTAKËT THEMELUES***

*Z. Romir Rexha*



DURRES 06/04/2021

*Z. Dardan Seferaj*

